

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në kuadër të procesit të konsultimit “Për projektligjin “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore” mirëpret sugjerimet nga qytetarët, ekspertë të fushës, nga të gjitha institucionet dhe subjektet e interesuara, organizata jofitimprurëse, shoqëria civile, të drejtat ose objekti i veprimtarisë të të cilave ka të bëjë apo ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga përcaktimet e kësaj nisme.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrit Elektronik: 20 ditë pune, duke filluar nga data 18.10.2024
15.11.2024.

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara me anë të regjistrit elektronik në adresën <http://ëëë.konsultimipublik.gov.al>.

Kontakti:

Eriola Jençeri, Koordinator për konsultimin publik në Ministri: eriola.kocileri@meki.gov.al
Jorgjeta Marko: jorgjeta.marko@meki.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 20 ditë pune, duke filluar nga data 18.10.2024.

Sfondi i propozimit legjislativ

Projektligji “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore” (në vijim Projektligji) ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, të periudhave të punësimit në institucionet dhe në ish-ndërmarrjet shtetërore deri më datë 1.10.1993, data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7703/1993; në ish-ndërmarrjet bujqësore deri më datën e hyrjes në fuqi të VKM nr. 452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore”, i ndryshuar dhe në ish-kooperativat bujqësore deri më datë 19.7.1991, data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
Synohet që përmes këtij projektligji, të mundësohet njohja e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, siç ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në

punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht, pa shpenzime për përfituesit dhe mbi të gjitha mundësohet përfitimi i e një pensioni, të paktën sa masa e pensionit social.

Propozimet

Ky projektligj ka si përparësi dhe efekte të pritshme:

1. Rritjen e mirëqenies së pensionistëve nëpërmjet përfitimit të pensioneve më të larta.
2. Njohjen e të drejtave të fituara, por të padokumentuara dhe rrjedhimisht njohjen e periudhave të sigurimit pa pengesa procedurale, sic ndodh kur dokumentacioni që pasqyron periudhën e vjetërsisë në punë paraqet mangësi që e bëjnë të pamundur njohjen e saj administrativisht.
3. Eliminimin e shpenzimeve gjyqësore për përfituesit dhe shmangien e proceseve gjyqësore dhe ankimimeve në komisionet rajonale dhe qendrore të ISSH.
4. Përfitimin e një pensioni, të paktën sa pensioni social.

Pyetjet

Reagimet që priten janë të hapura dhe nuk parashikohet ngritja e pyetjeve specifike, të cilat kërkojnë përgjigje. Pyetje të mundshme mund të jenë: A pajtoheni me qartësinë e informacionit të paraqitur në dokument dhe çfarë do të propozonit shtesë për të përmirësuar cilësinë e tij? Si i vlerësoni përcaktimet në këtë projektligj.